



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI  
ADRESA NR.3, HOXHA TASIM,  
NR.292  
TEL: 695761243

# KONTRATE SHITJE / DHURIM PASURIE TE LUAJTESHME

Nr. repertori: 1119

Nr. koleksioni: 314

Tirane më 21/02/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2020052730008492621

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



## MARRËVESHJE PËR BLERJEN E KUOTAVE

### ("Marreveshja")

Sot para meje noteres Valbona Selimi, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen Hoxha Tahsim, nr. 292, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

- **Z. Themistokli Foto**, lindur me 18.07.1969, ne Delvine, banues ne Tirane, mbajtes i pasaportes me nr. BA9751360, e nr. personal G90718081G, më tej referuar si "**Shitesi**",  
**dhe**
- **Znj. Xhenis Xhabafti**, e datelindjes 25.05.1995, lindur ne Tirane, banuese ne Tirane, e identifikuar me pasparten nr. BF9995679, me nr. Personal J55525072W, me tej referuar si "**Bleresi**".

### PALET BIET DAKORD SA VIJON:

#### 1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

##### 1.1 Përkufizime

Termet me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

"**Barrë**" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individi (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi per te blere ne te ardhmen apo te drejte parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigurues (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajtje te drejte ose cdo marrveshje sigurimi apo marreveshje ose rregullim tjetër barresues apo marreveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marreveshje tjetër per pagim me rezerve;

"**QKB**" nënkupton Qendra Kombëtare e Biznesit, organi publik Shqiptar që ka kompetencën e mbajtjes se dhe regjistrimeve në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

#### 2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

##### 2.1 Shitja e Kuotave

2.1.1 Ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete Marrëveshje, Bleresi blen te gjithe kuoten qe Shitesi zoteron ne Shoqerine shqiptare "Albanian Archives" sh.p.k. (me poshte referuar "**Shoqeria**") me NIPT L92023007L, të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre.

2.1.2 Transferimi i kuotes se Shitesit qe konsiston ne masen 40% te kapitalit themeltar te Shoqerise do të bëhet në përputhje me kete Marreveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

2.1.3 Titulli i pronesise mbi kuoten qe shitet do të transferohet tek Blerësi me lidhjen e kesaj kontrate, dhe kuota shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe perfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri ne kete date (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin,

shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri me sot).

## 2.2 Cmimi i Blerjes

Blerësi i paguan Shitësit për blerjen e kuotave një shumë të barabartë me 40.000 Lek ("Cmimi i Blerjes").

## 2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

Palet deklarojne se Bleresi e ka shlyer te plote Cmimin e Blerjes me lidhjen e kesaj Marreveshje.

## 3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### 3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet

3.1.1 Kjo Marrëveshje zhvleftëson cdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje.

3.1.2 Cdo ndryshim i kësaj Marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshje.

### 3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.

### 3.3 Regjistrimi i Marreveshjes

Palet bien dakort se regjistrimi i Marreveshjes ne QKB do te behet nga Bleresi brenda nje afati 15 ditor.

## 4. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE


Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare. Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

### Palet

**Themistokli Foto**



**Xhenis Xhabafti**



**Noter Valbona Selimi**

